



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr. 311/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Ramush Bardiqi dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bajram Sopjani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në vendvotim për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e palejuar ankesa ZL.Anr.311/2025, e datës 22.10.2025, e parashtruar nga kandidati Bajram Sopjani për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në vendvotim për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 22.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate, me të cilën pretendon se ka dyshime për parregullsi në numërimin e votave në Vendvotime 1954, 1927, 1938, 1932, 1919, 1922, 1920, 1917, 1928, 1911, 1906, 1909, 1904, 1924, 1935, 1936, 1942, 1921, 1916, 1915, 1902, 1914, 1929, 1903, 1907, 1925, 1923, 1950, 1951. Tutje kërkon që të bëhet rinumërimi ose verifikimi i votave për kandidatin nr. 5 të listës 186, për shkak se gjatë publikimit të rezultateve në nivel vendvotimi, është vërejtur se votat e tij nuk janë regjistruar të plota ose janë vendosur gabimisht në kandidatë të tjerë të listës.

Parashtruesi i ankesës pretendon se këto veprime bien ndesh me disa dispozita ligjore në fuqi, konkretisht me LZP dhe rregullat zgjedhore.

Në përgjigje në kërkesë KQZ me datë 23.10.2025, kishte sqaruar se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën tuaj japin sqarimet/përgjigjet si më poshtë: Ju njoftojmë se KQZ ju ka dërguar përgjigje lidhur me rastin konkret me datën 21.10.2025. Ndërsa PZAP me vendimin e datës 22.10.2025, e ka refuzuar ankesën si të pabazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e Subjektit Politik Nisma Socialdemokrate ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën ZL.Anr.279/2025, të paraqitur me datën 20.10.2025, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.279/2025, të datës 22.10.2025.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, ZLAnr.279/2025 të datës 22.10.2025 dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli e hedhi ankesën si të pa lejuar, pasi që ka rezultuar se bëhet fjalë për çështje të gjykuar.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura më lartë, në pajtim me nenin 115 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 5 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZLAnr.311/2025 më datën 24.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.